

VENDIM
Nr.248, datë 21.6.2004

PËR HEQJEN E LICENCËS SË "TV BUSHAT"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, i përbërë nga:

Sefedin Çela	Kryetar
Albert Minga	Zëvendëskryetar
Apostol Noti	Anëtar
Pashk Përvathi	Anëtar
Lazër Stani	Anëtar
Ilir Kulla	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit TV BUSHAT

Baza ligjore: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5, neni 34 pika 5 dhe neni 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimi nr.243, datë 21.5.2004 i KKRT-së.

Me vendimin nr.243, datë 21.5.2004 "Mbi vlefshmërinë e licencës së TV BUSHAT" është vendosur paraprakisht t'i hiqet licenca këtij subjekti, duke i lënë një afat prej 15 ditësh, për të dhënë mendimin e tij në lidhje me këtë vendim. Me shkresën e KKRT-së, me nr.577 prot., datë 24.5.2004, TV BUSHAT është njoftuar mbi vendimin nr.243, datë 21.5.2004 dhe nuk ka kthyer asnjë përgjigje.

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE I TELEVISIONIT,

pasi dëgjoi relatorët e çështjes, Argita Shkupi, Ermira Musha dhe Pirro Koçi, ndërsa subjekti në mungesë,

VËREN:

TV BUSHAT me pronar z.Simon Gjondrekaj është licencuar si operator televiziv vendor privat me vendimin nr.157, datë 30.7.2003 të KKRT-së, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5-vjetësh. Zona e licencimit të tij është komuna e Bushatit.

Në datën 21.4.2004 një grup inspektimi i KKRT-së ka shkuar në vendndodhjen studios së transmetimit të TV BUSHAT dhe ka mbajtur një procesverbal të shoqëruar me aktin e inspektimit.

Në bazë të procesverbalit dhe aktit të inspektimit rezulton se TV BUSHAT nuk ishte në transmetim. Studioja ku duhej të ishin instaluar aparaturat e transmetimit të këtij televizioni ishin krejtësisht të mbyllura.

KKRT-ja konstaton se TV BUSHAT nuk ka tërhequr licencën dhe nuk ka realizuar asnjë detyrim financiar që nga data e licencimit të tij. Këto detyrime janë si më poshtë:

- Taksa vjetore për shërbimet radiotelevizive në shumën prej 24 mijë lekësh;
 - Pagesa vjetore e licencës dhe pagesa për marrjen e licencës në shumën prej 34.3 mijë lekësh.
- Gjithashtu, ky subjekt nuk i është përgjigjur asnjëherë korrespondencës së KKRT-së.

Në bazë të nenit 34 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", KKRT-ja ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit, kur pas fillimit të transmetimit, gjatë një viti kalendarik, nuk transmetohet 30 ditë, pa llogaritur ndërprerjet për arsye teknike që nuk varen nga mbajtësi i licencës.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 dhe nenit 34 pika 5 dhe nenit 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion e televizionin publik

e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr.243, datë 21.5.2004 të KKRT-së,

VENDOSI:

1. T’i heqë licencën subjektit TV BUSHAT.
2. Licenca nr.062/TVL bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti ka të drejtën e ankimit në gjykatë.
4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
5. Kur është e domosdoshme, mbështetur në nenin 137/5 “Bashkëpunimi me organet e tjera” të bashkërendohen veprimet me organet tatimore e policore.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela